



Pranuar / Dorezuar Priljeño/Prodato Received/Delivered	22 - 03 2023	3	vit god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot.No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM4SH/C	2891/2023		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.266/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.266/2023 të datës 30.01.2023 të parashtruar nga ankuesi _____ të cilin me autorizim e përfaqëson Av. _____ me adresë _____, kundër organit të punësimit/Administrata Tatimore e Kosovës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 22.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.266/2023 e datës 30.01.2023 e parashtruar nga ankuesi _____

A r s y e t i m

Ankuesi _____ është i punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës, sipas Akt emërimit me Nr.Prot.02/100/09 të datës 12.05.2014 në pozitën *Inspektor tatimor i nivelit 2* në Zyrën Regjionale të ATK-së në Gjilan, në Departamentin-Operacionet përmbushëse.

Sipas Vendimit me Nr.Prot.03 të datës 27.04.2021, Komisioni Disiplinor në Administratën Tatimore të Kosovës e ka pezulluar procedurën disiplinore ndaj ankuesit, me arsyetimin se i njëjti është arrestuar me dyshimin se ka kryer veprën penale "*Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar*" deri në përfundimin e procedurës penale, rast ky i inicuar nga Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së sipas të cilit me vendimin e datës 15.04.2021 ankuesi është pezulluar përkohësisht nga marrëdhënia e punës me 50% të pagës gjatë kohëzgjatjes së pezullimit. Ndërsa me datën 11.11.2023 Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore pranë ATK-së, përmes shkresës zyrtare Nr.Prot.654 ka kërkuar nga Udhëheqësi i Divizionit të Pagesave pranë këtij institucioni që ankuesit të mos i ekzekutohet

pagesa prej 50% e pagës, bazuar në dispozitat e nenit 58 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publike dhe se nga ky muaj i njëjti duhet të shkoj në listë të pagave me zero (0).

Ankuesi i pakënaqur me shkresën zyrtare lidhur me ndërprerjen e 50% të pagës nga ana e Administratës Tatimore të Kosovës, me datën 23.12.2022 përmes përfaqësuesit të tij ka parashtruar ankesën me Nr.Prot.11.06 4746 tek Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës administrative, konstatimit të gabuar dhe jo të plote të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të ligjit. Ndërsa kjo e fundit me datën 30.12.2022 përmes shkresës zyrtare Nr.Prot.823 e ka njoftuar përfaqësuesin me autorizim të ankuesit lidhur me atë se pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Zyrtarë Publikë, kompetent për vendosje lidhur me realizimin e një te drejte është Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kundër shkresës zyrtare të datës 11.11.2022 me numër 654 të Administratës Tatimore të Kosovës, lidhur me ndërprerjen e 50% të pagës, ankuesi përmes përfaqësuesit me autorizim, me datën 30.01.2023 ka parashtruar ankesën me numër protokollit 1069/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës administrative-nenit 77, konstatimit të gabuar dhe jo të plote të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të ligjit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 07.02.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Administrata Tatimore e Kosovës. Ndërsa Këshilli, me datën 03.03.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga kjo e fundit së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 13.03.2023 sipas Vendimit me numër protokollit 2570/2023 ka vazhduar afatin për vendimmarrje edhe për 10 ditë pune lidhur me ankesën A.nr.266/2023 të datës 30.01.2023, të parashtruar nga ankuesi

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 1069/2023 të datës 30.01.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 30.01.2023 të përfaqësuesit të ankuesit; Shkresën zyrtare me Nr.Prot.823 të datës 30.12.2022 të Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore të ATK-së; Shkresën lidhur me fletëzën e protokollit mbi pranimin e vendimit sipas nr.rendor 823 nga ATK; E-mailin zyrtar të datës 30.12.2022 lidhur me dërgimin e vendimit nga ana e NJBNJ-së; Vendimin Nr.Prot.84 të datës 15.04.2021 të zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së; Gjendjen e llogarisë bankare të ankuesit të datës 05.10.2022; Ankesën e ankuesit të datës 23.12.2022 e parashtruar tek ATK; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 07.02.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 03.03.2023 nga Administrata Tatimore e Kosovës së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës; Akt emërimit të ankuesit me Nr.Prot.02/100/09 të datës 12.05.2014; Vendimin Nr.Prot.03 të datës 27.04.2021 të Komisionit Disiplinor të ATK-së; Listën e pagave për ankuesin për muajt maj, tetor dhe nëntor të vitit 2022; Shkresën zyrtare me Nr.Prot.654 të datës 11.12.2022 të Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore; Formularin e të dhënave për listën e pagave të datës 15.11.2022 si dhe Vendimin VK/2023 të datës 13.03.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke u bazuar në shkresat e lëndës përkatësisht provat e administruara në lidhje me këtë lëndë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka analizuar dispozitat e nenit 56 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë lidhur me pezullimin sipas detyrës zyrtare, me të cilat është përcaktuar se: *Nëpunësi civil pezullohet, sipas detyrës zyrtare të organit përkatës të punëdhënësit, në rastet si në vijim: 1.1. në rastin e procedurës disiplinore sipas paragrafit 5 të nenit 48 të këtij ligji; ... ndërlidhur me këtë neni 48 paragrafi 5 i po këtij ligji parasheh se: Nëse ka arsye të besohet se vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga nëpunësi civil, ndaj të cilit ka filluar një procedurë disiplinore, pengon hetimin disiplinor apo mund të cenojë ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij, komisioni disiplinor mund të vendosë pezullimin e nëpunësit civil ose të marrë çdo masë tjetër të përshtatshme, deri në marrjen e vendimit përfundimtar*”, rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore Kolegji konstaton se Komisioni Disiplinor mund të zbatoj masën e pezullimit të nëpunësit civil ndaj të cilit është duke u zhvilluar procedura disiplinore, në rast se vlerëson se qëndrimi apo ushtrimi i detyrës nga nëpunësi civil do të pengonte hetimin disiplinor apo do të përbënte cenim të detyrave të tij të punës.

Po ashtu, Kolegji duke u bazuar në dispozitat e nenit 58 paragrafit 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *4.Nëpunësi civil gjatë periudhës së pezullimit nuk përfiton pagë, me përjashtim në rastin e përcaktuar në paragrafin 1.1 të nenit 56, në rast se procedura përfundon pa një masë disiplinore dhe në rastin e përcaktuar në paragrafin 1.7 të nenit 56, nëpunësi përfiton 50 për qind të pagës së plotë, duke përjashtuar çdo lloj shtese në pagë për një periudhë pezullimi deri në 6 muaj*, konstatoi se në rast të pezullimit të nëpunësit civil sipas nenit 56 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të këtij Ligji, kompensimi prej 50% e pagës do të behët vetëm për një periudhë deri në gjashtë (6) muaj të pezullimit, rrjedhimisht çdo pezullim i vazhduar pas kësaj periudhe nuk bart të drejtën e kompensimit prej 50% të pagës së nëpunësit civil të pezulluar, andaj mbi këto arsye ligjore rezulton se janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me ndërprerjen e 50% të pagës në kuptim të dispozitave të theksuara si më lartë.

Siç u tha më sipër, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132 paragrafit 2 të Ligjit Nr.05/L-031 Për procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.266/2023, datë 22/03/2023.

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit me autorizim, Av.
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së